

KRONIKË E ZEZË

Arrestohet një 66-vjeçar në Vushtrri, gjuajti me armë zjarri në aheng familjar



Foto: Illustrim

Policia e Kosovës ka arrestuar të hënën mbrëma një 66-vjeçar në Vushtrri, nën dyshimin se ka shtënë me armë zjarri në një aheng familjar.

Sipas njoftimit të policisë të martën, në cilësinë e provave janë konfiskuar një armë e shkurtër dhe gjashtë gëzhoja.

"Mbrëmë rreth orës 23:00, në Stacionin Policor në Vushtri është raportuar për të shtëna me armë zjarri. Me të pranuar informacionin janë ndërmarrë veprime policore, ku pas një kohe të shkurtër në rrugën „Ana Lin” në Vushtri është identifikuar vendi ku në një aheng familjar ishin dëgjuar të shtënat, në cilësi të provave materiale është konfiskuar një armë e shkurt e llojit pistoletë dhe gjashtë (6) gëzhoja. Në cilësi të të dyshuarit është intervistuar Xh. A., 66 vjeçar, shtetas i Republikës së Kosovës, i cili dyshohet se ka shtënë me armë”, thuhet në njoftim.

© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#VUSHTRRI

#GJUAJTJE ME ARME ZJARRI

9 gusht 2022, 08:44

Shpërndaje në



Dy persona u arrestuan të dielën në Gërmi, sulmuan dy policë

Zhduket një person në Pejë

Arrestohen dy gra në Prishtinë, dyshtohen për prostitucion

Sulmohet seksualisht në
Kosovë një e mitur nga
Shqipëria

Prishtinë, tentohet të
rrëmbehet një grua

Arrestohet i mituri në Deçan,
theri disa herë me thikë një
tjetër të mitur

Punëtori i postës së shpejt në
Obiliq inskenon grabitjen e
mbi 900 eurove, arrestohet

TË TJERA

